


MË MIRË TË GJITHË



SESA VETËM NJË

KUVENDI

NDRIQIM (14), VLERA (14), ARGJENDA (14), XHENETA (15), MEXHID (14), YLL (14), BLERONA (14)



Në këtë vizatim kemi paraqitur disa fëmijë, të cilët janë shumë të lumtur. Kjo lumturi e tyre nuk është e rastësishme, ashtu siç nuk është e rastësishme ardhja jonë në këtë Punëtori sot. Lumturinë e njëjtë e kemi edhe ne

Mësoni arsyet e lumturisë së këtyre fëmijëve, duke mos lënë anash as lumturinë tonë që sot e përjetuam

Kuvendi është tema që sot grupi ynë ka diskutuar. Gjatë diskutimeve në grup, ne mësuam shumë gjëra të rëndësishme për këtë institucion, si dhe rëndësinë që Kuvendi ka në jetën tonë. Është pothuajse e pamundur që ky institucion të mos jetë i pranishëm në secilën sferë të jetës sonë, qoftë si qytetarë, qoftë si nxënës. Kur themi si nxënës, mendojmë për mundësitë që Kuvendi na ka ofruar. Njëra ndër këto mundësi ishte vendimi që nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta t'i kenë të siguruara të gjitha librat, prej klasës së parë deri në klasën e nëntë. Ky vendim pa dyshim që ka ndikuar në mirëqenien tonë si nxënës, por edhe në atë të familjes sonë. Prandaj, është një ndër vendimet më të rëndësishme. Kjo sepse ne kemi shumë shokë e shoqe që nuk kanë mundësi t'i sigurojnë librat.

Fillimisht, ky vendim është propozuar si projektligj nga Ministria e Arsimit, e pastaj pasi që është votuar dhe është miratuar në Kuvend, ka kaluar në ligj. Personat të cilët e kanë votuar këtë ligj janë deputetët, ndryshe përfaqësuesit e popullit. Ata janë kompetent të marrin vendime në emër të tij. Gjithsej janë 120 deputetë, të cilët na përfaqësojnë. Ky funksion ndryshe quhet funksioni përfaqësues i Kuvendit. Funksion tjetër i Kuvendit është ai legjislativ, ku propozohen dhe miratohen ligje të ndryshme, si ai i Ministrisë së Arsi-

mit. Si dhe funksion tjetër i Kuvendit është mbikëqyrja apo kontrolli i Qeverisë. Arsyeja pse Kuvendi e ushtron këtë funksion është sepse ligjet, të cilat miratohen në Kuvend, kanë ndikim në jetën tonë. Nëse këto ligje nuk zbatohen, atëherë kjo do të ishte në dëmin tonë si shoqëri. E tërë kjo procedurë që bëhet, e të gjitha këto funksione që Kuvendi ka, pa fije mëdyshje janë për të mirën e vendit.



Angazhimi i grupit për një artikull sa më të mirë



Së bashku kemi fuqinë të ndërtojmë të ardhmen



Institucioni që na siguron shumë të mira



Ne mësojmë shumë që të bëhemi qytetarë edhe më të mirë



Dioniku buzëqesh sepse është ai i cili ndërton demokracinë



Vetëm të bashkuar mund të arrijmë ndryshimin



Bleona duke shkruar për qytetarët e mirë

DEMOKRACIA NDRIÇON TË ARDHMEN TONË

ARMIR (13), LENDRIT (13), VALDRIN (14), ERZA (14), ARDITA (14), ENKELETA (14), FLORENTINA (14)



Si do të ishte jeta jonë po të mos kishim demokraci? Pse sistemi demokratik është sistemi më i mirë i qeverisjes? Cili është kontributi ynë në demokraci? Përgjigjet mund t'i gjeni në artikullin në vijim

Ne ndjehemi shumë të lumtur që jetojmë në një shtet demokratik. Të jetosh në demokraci do të thotë të kesh vlerë të madhe si person. Demokracia të jep të drejta të shumta dhe njëkohësisht të jep përgjegjësi. Disa nga përgjegjësitë që neve si qytetarë na takojnë janë: respektimi i ligjeve, trajtimi i barabartë dhe respektimi i të gjithëve, si dhe pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme, që për qëllim kanë vetëdijësimin e popullit lidhur me çështjet më të rëndësishme të shtetit. Meqenëse, demokracia është udhëheqje e popullit, kjo mundëson që secili qytetar të trajtohet i barabartë, sidomos në procesin e vendimmarrjes. Me këtë nënkuptojmë se populli në një shtet demokratik mund ta zgjedh të

ardhmen e tij. Në mënyrë që kjo e ardhme të jetë e ndritur, secili nga ne duhet t'i zbatoj elementet e demokracisë. Por, cilat elemente duhet zbatuar nga ne? Ne duhet të zbatojmë lirinë e shprehjes, tolerancën, respektin, barazinë, etj. Me zbatimin e këtyre elementeve, ne kontribuojmë në ndërtimin e mëtutjeshëm të demokracisë. Mirëpo, në ndërtimin e demokracisë na duhet edhe ndihma juaj. Prandaj, a dëshironi edhe ju të jeni qytetarë aktiv? Ejani dhe bëhuni pjesë e demokracisë, sepse e ardhmja nuk mund të ndërtohet pa përkushtim dhe pa zbatimin e elementeve të demokracisë. Ndryshimi fillon nga ti dhe nga qëllimi juaj për ndërtimin e shtetit tonë, Kosovës.



Secili nga ne duhet të kontribuoj në mënyrë që të kemi një të ardhme sa më të ndritur. Me kontributin e të gjithëve sigurohet mirëqenia sociale




Ne jemi autorët e artikullit, dhe sot erdhëm në përfundim se kemi vlerë shumë të madhe në shtetin tonë demokratik, veç se duhet të jemi të përkushtuar dhe paqësorë

POPULLI AKTIV

ERZA (14), DIONIK (15), EDUARD (13), BENISA (13), ELVIRA (13), BLEONA (14), ENIS (14), ERMAL (13)

Ne jemi nxënës që sot kemi pasur rolin e gazetarëve. Tema jonë është „Qytetaria aktive“ dhe nëse dëshironi të dini më shumë për këtë temë, atëherë mund të lexoni këtë artikull

Ndoshta ju mund të pyesni veten se çfarë është qytetaria aktive? Koncepti i qytetarisë aktive është një koncept i gjerë, për të cilin ka shumë përkufizime. Sipas nesh, qytetaria aktive përfshin të gjitha veprimet dhe aktivitetet që qytetarët bëjnë për t'u kujdesur për njëri-tjetrin. Njëri prej tyre është shoku ynë Learti, i cili ishte shumë i lumtur. Mirëpo, ai kishte shokë e shoqe, të cilët kishin nevoja të ndryshme. Për këtë arsye, ai vendosi që t'u ndihmonte sa më shumë. Ai iu dhuroi atyre të gjitha librat që nuk i duheshin, të gjitha rrobat që nuk i vishte më, dhe iu ndihmonte shumë në detyrat e shkollës. Kështu Learti ishte më i lumtur dhe të gjithë shokët e tij ishin të gëzuar. Ai është një qytetar aktiv dhe gjithashtu premton se kur t'i mbush 18 vjet do të dalë të votojë dhe të jetë pjesë e popullit aktiv.




Që të gjithë zbatojmë rregullat e komunikacionit



Punojmë për demokracinë



Ne ndërtojmë realitetin tonë



Kujdesi ndaj njëri-tjetrit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Ali Hadri“
Klasa: VIII-2
Vendi: Mirash, Ferizaj